


DEBATI NACIONAL

MBI REFORMAT ZGJEDHORE

NË MAQEDONINË E VERIUT

SONDAZI DELIBERATIV MBI AVANTAZHET DHE DISAVANTAZHET E

REFORMAVE TË NDRYSHME NË SISTEMIN ZGJEDHOR



European
Policy
Institute.
Skopje



NATIONAL
DEMOCRATIC
DEBATE



NATIONAL
ENDOWMENT
FOR
DEMOCRACY

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

PËRMBAJTJA

1. HYRJE/PYETJE & PËRGJIGJE

- 1.1. Pse ka nevojë për një dialog të hapur dhe të gjerë me qytetarët rreth reformave zgjedhore në Republikën e Maqedonisë së Veriut?
- 1.2. Cili është qëllimi i këtij dokumenti?
- 1.3. A është i ekuilibruar dhe i paanshëm informacioni i dhënë në këtë dokument?

3

3

4

4

2. SISTEMET ZGJEDHORE

- 2.1. Sistemi Pluralist/Mazhoritar
- 2.2. Sistemi Proporcional
- 2.3. Sistemi i përzier
- 2.4. Votimi jashtë vendit

5

5

5

7

7

3. SISTEMI ZGJEDHOR I MAQEDONISË SË VERIUT

- 3.1. Reformat zgjedhore në Maqedoninë e Veriut

9

11

4. SFIDAT DHE ÇËSHTJET KRYESORE TË IDENTIFIKUARA NË MAQEDONINË E VERIUT

- 4.1. Numri i njësive zgjedhore
- 4.2. Listat e kandidatëve për deputetë
- 4.3. Votimi jashtë vendit
- 4.4. Regjistrimi i votuesve


13


13

15

18

21





1. HYRJE/PYETJE & PËRGJIGJE

Zgjedhjet janë një nga karakteristikat kyçe të demokracive parlamentare përfaqësuese moderne. Ato janë një mjet që u mundëson njerëzve të zgjedhin përfaqësues që krijojnë politika që ndikojnë mbi ato në baza ditore. Zgjedhjet e lira dhe të drejta janë themeli i shoqërisë demokratike, ku interesat e shtetasve përfaqësohen dhe jepet llogari për to në mënyrë të drejtë.

Neni 2 i Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë së Veriut thotë se sovraniteti i vendit rrjedh nga dhe u takon shtetasve, ku qeverisja ushtrohet nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur në mënyrë demokratike, qoftë nëpërmjet një referendumit ose formave të tjera të shprehjes së drejtpërdrejtë të vullnetit të tyre, siç janë zgjedhjet.¹

Ka shumë sisteme dhe modele të ndryshme zgjedhore dhe nuk ka një mënyrë të drejtë për të zbatuar zgjedhjet, duke pasur parasysh se sistemet e ndryshme zgjedhore kanë avantazhet dhe disavantazhet e tyre. Ndërsa zgjedhja e sistemit zgjedhor është në thelb një proces politik, ka një sërë parimesh të vendosura që shërbejnë si udhëzime për vendet kur hartojnë sistemin e tyre zgjedhor, duke pasur parasysh ndikimin e tij në kuadrin më të gjerë politik dhe institucional.² Çfarëdo sistemi që zgjedh një vend, është e rëndësishme që ai të sigurojë zgjedhje të lira dhe të rregullta, duke pasqyruar shoqërinë dhe interesat e votuesëve, si dhe të sigurojë përfaqësimin e duhur të të gjitha grupeve.

1.1. PSE KA NEVOJË PËR NJË DIALOG TË HAPUR DHE TË GJERË ME QYTETARËT RRETH REFORMAVE ZGJEDHORE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT?

Ngjashëm me shumë procese reforme, reformat zgjedhore janë më shpesh të nxitura nga interesat e partive politike dhe grupeve elitare, interesat e të cilëve priren të forcohen rreth sistemit tanimë të zgjedhur, duke iu përgjigjur nxitjeve përkatëse. Ndërsa reformat zgjedhore janë kryer vazhdimisht në vend, ato më shpesh kryhen në dritën e zgjedhjeve të radhës, duke kufizuar hapësirën dhe kohën për një debat publik gjithëpërfshirës dhe transparent. Kjo rezulton me publik pjesërisht të informuar dhe konfuzion se pse nevojiten disa reforma apo si do të ndikojnë ato në procesin zgjedhor dhe rezultatet e zgjedhjeve. Rrjedhimisht, reformat mund të ndikojnë në atë se si kandidatët paraqiten dhe sa përgjegjës ndaj qytetarëve mund të jenë ata, si dhe në politikë bërjen e ardhshme dhe qeverisjen në vend. Në të njëjtën kohë, është e rëndësishme të theksohet se reformat zgjedhore mund të lindin ose të iniciohen nga shoqëria (qoftë nëpërmjet organizatave joqeveritare, grupeve të interesit, qytetarëve, etj.), për të trajtuar çështje që kanë të bëjnë me përfaqësimin, përgjegjshmërinë, stabilitetin e Qeverisë e kështu me radhë.

Qytetarët e zakonshëm, jeta e të cilëve do të ndikohet ndjeshëm nga proceset zgjedhore dhe rezultatet duhet të informohen siç duhet mbi pasojat e sistemeve zgjedhore në lidhje me parimet e përfaqësimit (gjeografik, ideologjik, gjinor, pakicë), gjithëpërfshirës, ndershmërisë dhe barazisë të votave dhe çështje të tjera të lidhura me rëndësi për politikë bërjen dhe qeverisjen në përgjithësi. Kjo është arsyeja se pse edukimi i votuesve është jashtëzakonisht i rëndësishëm.

1 "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" N. 1/92, 31/98, 91/01, 84/03, 107/05, 3/09, 49/11, 6/19 dhe 36/19

2 Instituti Ndërkombëtar për Demokraci dhe Asistencë Zgjedhore(2005) Projektim i Sistemit Zgjedhor: Përmbledhje e Manualit të Ri Ndërkombëtar IDEA, (International Institute for Democracy and Electoral Assistance (2005) Electoral System Design: Overview of the New International IDEA Handbook, International IDEA), International IDEA

Ky Debat Kombëtar mbi Reformat Zgjedhore synon të hedhë dritë mbi rezultatet e mundshme të ndryshimeve në modelin zgjedhor, duke kapërcyer hapësirën e dialogut të fragmentuar dhe jo-përfshirës mbi reformat zgjedhore. Përveç kësaj, ai synon të rrisë përfshirjen e qytetarëve në reformën e ardhshme të sistemit zgjedhor, nëpërmjet një dialogu gjithëpërfshirës, objektiv me ekspertët dhe vendim-marrësit e duhur.

1.2. CILI ËSHTË QËLLIMI I KËTIJ DOKUMENTI?

Është e rëndësishme të theksohet se në këto materiale dhe për qëllimin e këtij Sondazhi Deliberativ, **fokusi është vetëm në zgjedhjet parlamentare**. Ky dokument është një përmbledhje e katër temave të diskutimit të sondazhit deliberativ. Dokumenti ofron:


1. **Informacion teorik dhe të përgjithshëm rreth zgjedhjeve dhe sistemeve zgjedhore, duke përfshirë llojet dhe modelet e ndryshme;**
2. **Prapavijën e sistemit zgjedhor në Maqedoninë e Veriut me fokus të veçantë në katër pikat e diskutimit: numri i njësive zgjedhore, lloji i listave, votimi jashtë vendit dhe regjistrimi i votuesve;**
3. **Informacion në lidhje me modelet dhe opsionet e ndryshme (pra reformat e mundshme) në lidhje me katër temat, duke paraqitur argumentet për dhe kundër secilit opsion/reformë.**

Ndërsa ka shumë aspekte të sistemeve zgjedhore dhe modeleve të ndryshme zgjedhore në të gjithë botën, për shkak të kufizimeve kohore, fokusi i debatit - pra edhe i këtij dokumenti - është mbi numrin e njësive zgjedhore, llojet e listave, votimi jashtë vendit dhe regjistrimi i votuesve, si katër tema të mëdha lidhur me reformat zgjedhore në Maqedoninë e Veriut në vitet e fundit. Ndërsa dokumenti nuk paraqet të gjitha qasjet e mundshme të politikës dhe argumentet në favor dhe kundër opsioneve të ofruara për secilën nga temat, ai shërben si një bazë për stimulimin e këtyre diskutimeve. Jeni të mirëpritur të diskutoni argumentet për dhe kundër që janë të pranishme në këtë dokument, dhe gjithashtu të sillni argumentet tuaja për të çuar më tej diskutimet. Argumentet lidhur me rrugët alternative janë më se të mirëpritura.

1.3. A ËSHTË I EKUILIBRUAR DHE I PAANSHËM INFORMACIONI I DHËNË NË KËTË DOKUMENT?

Gjatë hartimit të këtij dokumenti, ishte shumë e rëndësishme që informacioni i dhënë të ishte objektiv, i ekuilibruar dhe i paanshëm. Ne jemi konsultuar me ekspertë kryesorë me këndvështrime të ndryshme mbi temat dhe hartuam dokumentin me ndihmën e partnerëve tanë. Personat që e redaktuan dokumentin për të siguruar ekuilibrin dhe saktësinë janë:

- **Prof. Dr. Besa Arifi**
- **Dr. Elena B. Stavrevska**
- **Prof. Dr. Jovan Ananiev**
- **Prof. Dr. Renata Deskoska Trenevka**
- **Prof. Dr. Veli Kreci**
- **Doc. Dr. Denis Preshova**



2. SISTEMET ZGJEDHORE

Sistemi zgjedhor, në thelb, është një sërë rregullash që ndihmojnë në përkthimin e votave në numër mandatesh të fituara nga partitë politike apo kandidatët. Nuk ka sistem ideal zgjedhor dhe zgjedhja e modelit varet nga një numër faktorësh si dhe nga objektivat që një vend dëshiron të arrijë, të cilat ndonjëherë mund të jenë kontradiktore me njëra-tjetrën ose reciprokisht përjashtuese. Ndërsa ka disa variabla të rëndësishme që përcaktojnë sistemin zgjedhor në një kuptim më të gjerë, tre elemente janë kryesore - formula zgjedhore (lloji i sistemit zgjedhor), formula matematikore (si llogariten votat) dhe lloji i votimit (lista e kandidatëve). Ka shumë variacione të ndryshme në sistemin zgjedhor, por mënyra më e zakonshme për t'i grupuar ato është të shihet se sa proporcionale janë ato, domethënë të shihet sa saktë i përkthejnë votat në mandate. Në këtë drejtim, ne bëjmë dallimin midis pluralitetit/ sistemit shumicë, sistemit gjysmë-proporcional, sistemit proporcional dhe sistemit të përzier.³

2.1. SISTEMI PLURALIST/MAZHORITAR

Në sistemin mazhoritar, me qëllim që të zgjidhen, kandidatët duhet të kenë një shumicë nga numrit i përgjithshëm i votave. Zakonisht, ky sistem përdor njësi zgjedhore me një anëtar, ku votat hidhen për kandidatët, në vend të partive politike.⁴ Disa nga nën-sistemet kërkojnë një shumicë absolute të votave, ndërsa të tjera një shumicë të thjeshtë (relative). Dy sistemet më të zakonshme mazhoritare janë i **pari që e kalon pragun** (FPTP) dhe vota **alternative (VA)**. Në sistemin e FPTP, kandidati fitues duhet të fitojë më shumë vota se çdo tjetër, pavarësisht nëse fiton një shumicë absolute të votave të hedhura. Në sistemin VA, kandidati fitues duhet të marrë një shumicë absolute të votave, pra më shumë se 50%. Ndërsa FPTP konsiderohet e thjeshtë dhe e lehtë për t'u kuptuar nga votuesit, VA ofron më shumë opsione për votuesit, pasi ata mund t'i renditin kandidatët në fletëvotimin, sipas preferencave të tyre.

2.2. SISTEMI PROPORCIONAL

Ideja prapa sistemit proporcional (SP) është të sigurojë që partitë/kandidatët të marrin një numër mandatesh që janë proporcionale me pjesën e votave që kanë fituar – për shembull, nëse partia A merr 40% të votave, ajo do të merrte 40% të mandateve. Ky sistem kërkon njësi zgjedhore shumë-anëtarëshe, ndërsa numri i njësive është i parëndësishëm – mund të ketë më shumë se një njësi, ose i gjithë territori i një vendi mund të jetë një njësi. Ka tre variabla kryesore që janë të rëndësishme nën PR - formula matematikore e përdorur për të përkthyer votat në mandate, madhësia e njësive zgjedhore dhe pragu i kërkuar për përfaqësim. Sa më i madh të jetë numri i përfaqësuesve që do të zgjidhen nga një njësi zgjedhore dhe sa më i ulët të jetë pragu i kërkuar për përfaqësim në legjislaturë, aq më proporcional do të jetë sistemi zgjedhor dhe partitë e vogla do të kenë më shumë shanse për të fituar përfaqësim.⁵ Me formulë matematikore, mandatet ndahen ose me anë të mesatares më të lartë, ose me anë të pjesës më e madhe të mbetur. Formulatat më të përdorura janë **kuota Hare**, formula **d'Hondt** dhe formula **Sainte-lague**. Meqë llojet e formulës zgjedhore bien jashtë sferës së kësaj ngjarjeje të Sondazhit Deliberativ, ato nuk diskutohen në këtë dokument. Megjithatë, metoda d'Hondt shpjegohet në kapitullin tjetër, pasi aktualisht përdoret në Maqedoninë e Veriut.

3 Instituti Ndërkombëtar për Demokraci dhe Asistencë Zgjedhore (2005) Projektim i Sistemit Zgjedhor: Përmbledhje e Manualit të Ri Ndërkombëtar IDEA, (International Institute for Democracy and Electoral Assistance (2005) Electoral System Design: Overview of the New International IDEA Handbook, International IDEA), International IDEA

4 Ibid.

5 Ibid.

LLOJET E SISTEMEVE PR

Sistemet PR më të njohura janë lista PR dhe vota e vetme e transferueshme (VVT).

Në **sistemet proporcionale të listave PR**, partitë ose grupet e pavarura paraqesin një listë të kandidatëve për një njësi zgjedhore shumë-anëtarëshe për elektoratin, për të cilën ata marrin një pjesë të mandateve në bazë të votave të fituara. Ky është sistemi zgjedhor më i përdorur. Ka variacione të sistemeve PR të listës, duke përfshirë ato të bazuara në llojin e listave/fletëvotimeve.

Listat e mbyllura janë ato ku partitë/grupet e pavarura paracaktjnë rendin e kandidatëve në listën e tyre, prandaj sa më i lartë të jetë një kandidat në listë, aq më të mëdha janë shanset që ai kandidat të fitojë një mandat. Kështu që, në sistemet e PR me lista të mbyllura, votuesit japin votën e tyre për një parti/grup të pavarur dhe nuk marrin pjesë në përzgjedhjen e kandidatëve të caktuar. Në shumicën e vendeve me sistemet e Listave PR, listat janë të mbyllura.

Sistemet PR me lista të hapur janë ato ku përveç votimit për një parti politike, votuesit mund të ndikojnë edhe në rendin e kandidatëve sipas preferencave të tyre individuale. Është e rëndësishme të theksohet se sistemet e listës së hapur mund të ndryshojnë në nivelin e tyre të "hapjes", duke filluar nga listat plotësisht të hapura ku numri absolut i votave që fiton një kandidat përcakton nëse një mandat është fituar, në relativisht të mbyllur, ku një kandidat duhet të marrë një kuotë të plotë të votave në mënyrë që të fitojë një mandat. Bazuar në metodën e votimit, mund të ketë aq lloje të sistemeve PR të listës së hapur, sa ka vende që e përdorin atë. Në këtë kuptim, në disa vende votuesve mund t'u kërkohet së pari të votojnë për një listë dhe pastaj për kandidat. Në vende të tjera, sistemi i listës së hapur është më i përqendruar te kandidati, që do të thotë se votuesit zakonisht mund të votojnë për një deri në tre kandidatë dhe shumë rrallë për më shumë se tre. Ka edhe vende që i kombinojnë këto dy elemente, ose u mundësojnë votuesve të votojnë për kandidatë nga parti të ndryshme/organizata të pavarura.⁶

Sistemet PR me lista të lira janë ato ku votuesve u jepen aq vota sa mandate dhe ato ose mund t'ua japin kandidatëve nga e njëjta parti, ose t'ua japin kandidatëve nga parti të ndryshme. Listat e lira përdoren në shumë pak vende në botë dhe ato ofrojnë kontroll më të madh për votuesin se çdo lloj tjetër liste.

Sistemi VVT përdor votimin preferencial në njësitë zgjedhore shumë-anëtarëshe, që do të thotë se votuesit mund t'i rendisin kandidatët sipas preferencës së tyre. Sidoqoftë, kur përdoret sistemi VVT, renditja është kryesisht opsionale, që do të thotë se ata mund të shënojnë vetëm një kandidat, pa renditur të gjithë kandidatët.⁷

Për shkak të mundësisë për renditjen e kandidatëve, ky sistem ofron shanse më të mira për kandidatët popullorë të pavarur, sesa sistemi me listë PR. Në sistemin VVT, llogaritja e vendeve bëhet duke përdorur formulën e kuotës Hare.

6 Wall, Alan (2021) Open List Proportional Representation: The Good, the Bad and the Ugly. Instituti Ndërkombëtar për Demokraci dhe Asistencë Zgjedhore

7 Instituti Ndërkombëtar për Demokraci dhe Asistencë Zgjedhore(2005) Projektim i Sistemit Zgjedhor: Përmbledhje e Manualit të Ri Ndërkombëtar IDEA, (International Institute for Democracy and Electoral Assistance (2005) Electoral System Design: Overview of the New International IDEA Handbook, International IDEA), International IDEA

2.3. SISTEMI I PËRZIER

Sistemi i përzier kombinon elementë si nga sistemi pluralist/mazhoritar, ashtu edhe nga sistemi i PR, domethënë ekzistojnë dy sisteme zgjedhore që funksionojnë paralelisht, që përdorin formula të ndryshme për të dhënë rezultatet e zgjedhjeve. Tre llojet më të zakonshme të sistemeve të përziera janë **vota e vetme e patransferueshme (VVPT), sistemi paralel dhe sistemi PR me anëtarë të përzier.**

Në nënsistemin **VVPT**, votuesit kanë një votë, edhe pse ka disa mandate për t'u fituar. Prandaj, mandatet plotësohen nga kandidatët që fitojnë më shumë vota. Për shembull, nëse ka 3 mandate, ato plotësohen nga tre kandidatët e parë që kanë fituar më shumë vota. Sistemi paralel është i ngjashëm me PR me anëtarë të përzier në të cilin përdoren dy sisteme (sistemi i listës PR dhe zakonisht pluralist/mazhoritar), me ndryshimin se listat proporcionale nuk kompensojnë ndonjë disproporcionalitet brenda njërive zgjedhore mazhoritare.⁸ Prandaj, kjo formë e sistemit të përzier jep ndarje më të ulët proporcionale të mandateve sesa PR me anëtar të përzier. Sistemi PR me **anëtarë të përzier kombinon** karakteristika të të dy sistemeve atij mazhoritar dhe PR – një pjesë e mandateve ndahen duke përdorur një metodë pluraliste/mazhoritare, më së shpeshti në njësitë zgjedhore me një anëtar të vetëm, ndërsa mandatet e mbetura ndahen përmes listës PR. Në këtë sistem, sistemi i listës PR përbën disproporcionalitetin e shkaktuar nga rezultatet nga njësitë zgjedhore me një anëtar të vetëm.⁹

2.4. VOTIMI JASHTË VENDIT

Votimi jashtë vendit, ose votimi i jashtëm përcaktohet si "procedura që u mundësojnë disa ose të gjithë votuesve të një vendi që janë përkohësisht ose përgjithmonë jashtë vendit të ushtrojnë të drejtat e tyre të votimit nga jashtë territorit kombëtar."¹⁰

Të drejtat e votës në shoqëritë demokratike janë thelbi i të drejtave politike të njerëzve, megjithatë votimi nga jashtë mbetet një pyetje mjaft përçarëse, veçanërisht në lidhje me atë se çfarë sistemi zgjedhor duhet të zbatohet, si duhet të organizohet kjo, kush duhet të ketë të drejtë të votojë, cilat duhet të jenë modalitetet e votimit. Është gjithashtu e rëndësishme të bëhet dallimi midis modeleve të votimit jashtë vendit bazuar në vendin ku shkojnë votat - nëse ato numërohen në njësi zgjedhore të veçanta, jashtë vendit, ose nëse ato i shtohen votave të marra në njësitë zgjedhore brenda vendit, sipas vendit të fundit të banimit në vendin e origjinës së çdo të larguari. Ashtu si pjesa tjetër e çështjeve lidhur me sistemin zgjedhor, nuk ka asnjë mënyrë të drejtë për të hartuar dhe organizuar votimin jashtë vendit, varet nga çdo vend për të vendosur mbi të. Më shpesh, votuesit jashtë vendit mund të marrin pjesë në zgjedhje në nivel kombëtar, pra në zgjedhje presidenciale dhe/ose parlamentare.

Ndërsa sigurimi i të drejtës së votës për jorezidentët konsiderohet praktikë evropiane që e kanë miratuar të gjitha vendet anëtare të BE-së, ka vende në botë që nuk organizojnë votim jashtë vendit. Nga 216 shtete dhe territore anëmbanë botës, 125 shtete dhe territore lejojnë njerëzit që jetojnë jashtë të votojnë në zgjedhjet legjislative dhe 88 lejojnë votimin jashtë vendit në zgjedhjet presidenciale. Në përgjithësi, rreth 73% e shteteve dhe territoreve kishin miratuar një formë të OCV deri në vitin 2020.¹¹


8 Ibid.

9 Instituti Ndërkombëtar për Demokraci dhe Asistencë Zgjedhore(2005) Projektim i Sistemit Zgjedhor: Përmbledhje e Manualit të Ri Ndërkombëtar IDEA, (International Institute for Democracy and Electoral Assistance (2005) Electoral System Design: Overview of the New International IDEA Handbook, International IDEA), International IDEA

10 Instituti Ndërkombëtar për Demokraci dhe Asistencë Zgjedhore(2007) Votimi nga jashtë: Manuali Ndërkombëtar IDEA, (International Institute for Democracy and Electoral Assistance (2007) Voting from Abroad: The International IDEA Handbook, International IDEA, International IDEA), International IDEA

11 Ibid.

Fotografia 1: Shtetet që kanë miratuar votimin nga jashtë



Source: International IDEA, Voting from Abroad Database, 2020, <<https://www.idea.int/data-tools/data/voting-abroad>>, accessed 19 November 2020.


Burimi: International IDEA, Voting from Abroad Database, 2020,

<https://www.idea.int/data-tools/data/voting-abroad>

Votimi jashtë vendit nuk është i lejuar

Votimi jashtë vendit është i lejuar

Vende pa zgjedhje nacionale direkte



3. SISTEMI ZGJEDHOR I MAQEDONISË SË VERIUT

Maqedonia e Veriut ka një sistem shumë partiak, me gjithsej 57 parti politike të regjistruara aktualisht.¹² Bazuar në karakterin shumë-etnik të vendit, ka gjithashtu parti politike që përfaqësojnë interesat e grupeve të veçanta etnike. Partitë politike mund të garojnë në zgjedhjet parlamentare për deputetë të Parlamentit, zgjedhjet lokale për kryetarët e komunave dhe anëtarët e këshillave komunalë dhe zgjedhjet presidenciale.

Kuadri legjislativ lejon gjithashtu që kandidatët e pavarur të garojnë në zgjedhje. Paraqitja e kandidaturës paraprihet nga mbledhja e një numri të caktuar nënshkrimesh (siç e parashikon Kodi Zgjedhor), qoftë nga votuesit, qoftë nga deputetët, në varësi të paraqitjes së kandidaturës në emër të kandidatit/kandidatëve të pavarur. Nënshkrimet mblidhen në njësitë rajonale të Komisionit Shtetëror Zgjedhor (KSHZ) dhe procedura përcaktohet në Rregulloren e miratuar nga KSHZ.

Ndërsa zgjedhjet e rregullta presidenciale mbahen çdo pesë vjet, zgjedhjet e rregullta lokale e parlamentare mbahen çdo katër vjet. Megjithatë, për shkak të paqëndrueshmërisë politike në vend dhe shpesh për shkak të kalkulimeve politike, zgjedhjet e parakohshme janë të shpeshta.

Që nga shpallja e pavarësisë, në vend janë organizuar zgjedhje të shumta, duke përdorur sisteme të ndryshme zgjedhore:


- » 1990 – **Zgjedhje parlamentare** (sistem zgjedhor mazhoritar, 120 njësi zgjedhore me një anëtar);
- » 1994 – Zgjedhjet presidenciale dhe **zgjedhjet parlamentare** (sistemi zgjedhor mazhoritar, 120 njësi zgjedhore me një anëtar);
- » 1996 – Zgjedhjet lokale;
- » 1998 – **Zgjedhjet parlamentare** (sistem zgjedhor i përzier/paralel – 85 deputetë të zgjedhur nga 85 njësi zgjedhore me një anëtar dhe 35 deputetë të zgjedhur përmes një sistemi proporcional duke përdorur formulën d'Hondt, në një njësi zgjedhore);
- » 1999 – Zgjedhjet presidenciale;
- » 2000 – Zgjedhjet lokale;
- » 2002 – **Zgjedhjet parlamentare** (sistemi zgjedhor proporcional, 6 njësi zgjedhore me shumë anëtarë);
- » 2005 – Zgjedhjet lokale;
- » 2006 – **Zgjedhjet parlamentare** (sistemi zgjedhor proporcional, 6 njësi zgjedhore me shumë anëtarë);
- » 2008 – **Zgjedhjet parlamentare të parakohshme** (sistemi zgjedhor proporcional, 6 njësi zgjedhore me shumë anëtarë);
- » 2009 – Zgjedhjet presidenciale dhe zgjedhjet lokale;
- » 2011 – **Zgjedhjet e parakohshme parlamentare** (sistemi zgjedhor proporcional, 6 njësi zgjedhore me shumë anëtarë në vend, 3 njësi zgjedhore me një anëtar të vetëm jashtë vendit);
- » 2013 – Zgjedhjet lokale;
- » 2014 – Zgjedhjet presidenciale dhe **Zgjedhjet e parakohshme parlamentare** (sistemi zgjedhor proporcional, 6 njësi zgjedhore me shumë anëtarë në vend, 3 njësi zgjedhore me një anëtar të vetëm jashtë vendit);
- » 2016 - **Zgjedhjet e parakohshme parlamentare** (sistemi zgjedhor proporcional, 6 njësi zgjedhore me shumë anëtarë në vend, 1 njësi zgjedhore me shumë anëtarë jashtë vendit);

¹² Sipas të dhënave të ofruara nga Agjencia për Mbrojtjen e të Drejtës për Qasje të Lirë në Informacionet Publike. Shiko <https://aspi.mk/imateli/8/>

- » 2017 – Zgjedhjet lokale;
- » 2019 – Zgjedhjet presidenciale;
- » 2020 – **Zgjedhjet e parakohshme parlamentare** (sistemi zgjedhor proporcional, 6 njësi zgjedhore me shumë anëtarë në vend, 1 njësi zgjedhore me shumë anëtarë jashtë vendit);
- » 2021 – Zgjedhjet lokale.

Që nga viti 2002, sistemi zgjedhor parlamentar në Maqedoninë e Veriut është proporcional, me lista të mbyllura kandidatësh. 120 deputetë zgjidhen në gjashtë njësi zgjedhore dhe rezultatet llogariten duke përdorur formulën **d'Hondt**. Deri në tre deputetë shtesë zgjidhen përmes votimit jashtë vendit,¹³ në një njësi zgjedhore.¹⁴ Nga votimi brenda vendit zgjidhen 20 deputetë nga secili prej gjashtë njësive zgjedhore. Në kapitujt vijues jepen detaje të mëtejshme në lidhje me njësitë zgjedhore, votimin jashtë vendit, llojet e listave dhe Regjistrin e Votuesve.

Fotografia 2: Zgjedhja e deputetëve në Maqedoninë e Veriut



Formula D'Hondt e përdorur për të llogaritur mandatet bazuar në votat e dhëna për çdo listë kandidatësh në Maqedoninë e Veriut ndjek metodën e mesatares më të lartë. Numri i përgjithshëm i votave të secilës parti pjesëtohet në mënyrë të përsëritur nga një ndarës i përbashkët (1, 2, 3...etj.), ku çdo ndarje rezulton me një mesatare. Listës së kandidatëve me mesataren më të lartë i jepet mandati i parë. Mesatares së dytë më e lartë i jepet mandati i dytë, etj. (deri në plotësimin e të gjitha mandateve). Kjo formulë lejon një shpërndarje të vendeve sipas rendit të përparësisë. Ndërsa kjo metodë ka një proporcionalitet relativisht të ulët në lidhje me shpërndarjen e vendeve në krahasim me formulat e tjera (për shembull Hare ose Saint Lague), ajo minimizon numrin e votave të lëna mënjanë, në mënyrë që votat e mbetura të përfaqësohen proporcionalisht.¹⁵ Në të njëjtën kohë, (në varësi të faktorëve të tjerë si madhësia e njësisë zgjedhore dhe numri i mandateve për shembull) ai tenton të përforcojë avantazhin e listave zgjedhore duke fituar numër më të lartë votash në dëm të atyre që marrin më pak vota. Sot, metoda d'Hondt është metoda më e përdorur në të gjithë vendet për llogaritjen e mandateve.

¹³ Që nga viti 2011

¹⁴ Që nga viti 2015

¹⁵ Medzhorsky, Juraj (2019) Rethinking the D'Hondt method. Political Research Exchange, 1:1, 1-5.

Tabela 1. Simulim për ndarjen e tetë mandateve me tre parti

Partia	Partia A	Partia B	Partia C
Votat e marra	10.000	6.000	1.500
Ndarës			
1	10.000	6.000	1.500
2	5.000	3.000	750
3	3.333	2.000	500
4	2.500	1.500	
5	2.000	1.200	
6	1.667	1.000	
7	1.428	857	
Numri total i mandateve të fituara	5	3	0

Pavarësisht numrit të madh të partive politike, shumica e partive të vogla kandidojnë në zgjedhje me një koalicion parazgjedhor, zakonisht të udhëhequr nga një prej dy partive më të mëdha politike – Lidhja Social-Demokrat e Veriut (LSDM) ose Organizata e Brendshme Revolucionare Maqedonase, Partia Demokratike për Unitetin Maqedonas (VMRO DPMNE), me qëllim që të rriten shanset e tyre për t'u përfaqësuar në Parlament.

Maqedonia e Veriut është një demokraci konsociacionale, e cila, midis elementëve të tjerë kryesorë, karakterizohet nga formimi i një qeverie të madhe të koalicionit që përfaqëson grupet e ndryshme etnike.¹⁶ Në praktikë, kjo do të thotë se koalicionet pas-zgjedhore janë formuar midis një prej dy partive më të mëdha maqedonase (që zakonisht fiton numrin e përgjithshëm më të madh të vendeve) dhe një (ose më shumë) prej partive shqiptare. Një zhvillim interesant në formimin e koalicionit ndodhi në vitin 2020, kur u ra dakord për koalicionin e parë qeverisës parazgjedhor midis një partie maqedonase dhe një prej partive më të mëdha shqiptare, përpara zgjedhjeve parlamentare të vitit 2020, ku LSDM bëri koalicion me partinë etnike shqiptare BESA.

3.1. REFORMAT ZGJEDHORE NË MAQEDONINË E VERIUT

Brenda procesit të pranimit në BE, reformat zgjedhore janë zbatuar nën ombrellën e reformave demokratike. Ndonëse vendi kryen vazhdimisht reforma zgjedhore, reformat kyçe më së shpeshti zbatohen përpara zgjedhjeve. Ky seksion ofron një pasqyrë të shkurtër të reformave të mëdha zgjedhore të zbatuara në pesë ciklet e fundit zgjedhore parlamentare (2008 – sot).

Në përgjithësi, Kodi Zgjedhor pëson ndryshime të shpeshta, veçanërisht përpara zgjedhjeve, në aspekt të trajtimit të rekomandimeve të ndryshme nga OSBE/ODIHR dhe Komisioni i Venecias. Sidoqoftë, kjo nuk konsiderohet një praktikë e mirë sipas standardeve ndërkombëtare të dhëna "sepse ndikon në zbatimin në kohë dhe në mënyrë të qëndrueshme të ligjit."¹⁷ Për më tepër, edhe pse dispozitat e Kodit Zgjedhor prekin çdo qytetar, procesi i miratimit të ri të ndryshimit të legjislacionit zgjedhor ekzistues ndër vite ka qenë kryesisht jo gjithëpërfshirës, duke i bërë reformat zgjedhore pothuajse një subjekt ekskluziv të negociatave politike midis partive politike.

¹⁶ Lijphard, Arend (1975). *The Politics of Accommodation: Pluralism and Democracy in the Netherlands*. University of California Press.

¹⁷ Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë Zyra e Institucioneve Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut. (2011). *Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare 5 qershor 2011. Raporti Përfundimtar i Misionit të Vëzhgimit të Zgjedhjeve të OSBE/ODIHR* (pp.1). Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë.

Pas miratimit të Kodit Zgjedhor në vitin 2006, u ndryshuan disa ligje për të konsoliduar kuadrin legjislativ në lidhje me zgjedhjet, megjithatë kuadri legjislativ konsiderohej ende i fragmentuar dhe kishte nevojë për konsolidim të mëtejshëm.¹⁸ Komisioni Shtetëror Zgjedhor (KSHZ) u krijua si një organ i përhershëm, i përbërë nga shtatë anëtarë me një mandat pesë-vjeçar, i ngarkuar për të mbikëqyrur përgatitjen e zgjedhjeve.

Votimi jashtë vendit u fut për herë të parë në vitin 2011. Zgjedhjet jashtë vendit u zhvilluan sipas sistemit mazhoritar, në tre njësi zgjedhore: Njësia Zgjedhore 7 – Evropa dhe Afrika, Njësia Zgjedhore 8 – Amerika e Veriut dhe e Jugut, dhe Njësia Zgjedhore 9 – Australia dhe Azia. Në vitin 2015, të tre njësitë zgjedhore u shkrinë në një, ku zgjidhen deri në tre deputetë sipas sistemit proporcional. Në qoftë se regjistroheshin votues të mjaftueshëm për të votuar dhe bëhen zgjedhje, zgjedhja e këtyre deputetëve është e kushtëzuar nga fitimi i numrit minimal të votave që nevojiten për të fituar një mandat në një nga gjashtë njësitë zgjedhore brenda vendit.

Sipas negociatave politike të nivelit të lartë për zbatimin e Marrëveshjes së Përzahinos për zgjidhjen e krizës politike të shkaktuar nga përgjimi i paligjshëm i komunikimeve, Kodi Zgjedhor pësoi një raund tjetër amendamentesh përpara zgjedhjeve të parakohshme parlamentare të vitit 2016. Numri i anëtarëve të KSHZ-së u rrit nga shtatë në nëntë - tre anëtarë ekspertë dhe gjashtë anëtarë të zgjedhur me propozim të katër partive më të mëdha politike në vend. Përveç kësaj, kuota për përfaqësimin e grave në listat e kandidatëve u rrit nga 30% në 40%. Ky grup amendamentesh futi gjithashtu formimin e të ashtuquajturës Qeveri e Kujdesit, e ngritur 100 ditë përpara zgjedhjeve, për të siguruar kryerjen e zgjedhjeve të lira e të rregullta demokratike parlamentare.

Stabiliteti ligjor u dëmtua përsëri para zgjedhjeve të parakohshme parlamentare të vitit 2020, me rishikime thelbësore të Kodit Zgjedhor dhe “rregulloreve ad hoc të miratuara gjatë gjendjes së jashtëzakonshme [për shkak të pandemisë Kovid19]” që adresuan rekomandimet e OSBE/ODIHR vetëm pjesërisht.¹⁹

Gjatë gjithë viteve, shumë nga reformat e kryera i referoheshin gjithashtu Listave Zgjedhore. KSHZ-ja u ngarkua me përgjegjësinë të përditësoj dhe mirëmbajë listën e zgjedhore në vitin 2011, një kompetencë që më parë mbahej nga Ministria e Drejtësisë. Një rishikim i plotë i listës zgjedhore u krye para zgjedhjeve të vitit 2016, përmes kontrollit të disa grupeve të të dhënave dhe kontrolleve në terren, të cilat rezultuan me një numër të kufizuar fshirjesh të votuesve.²⁰ Pasi u vendos Regjistri Qendror i Popullsisë,²¹ ai u bë një nga dy burimet kryesore për përditësimin dhe mirëmbajtjen e Listës zgjedhore. Sidoqoftë, Regjistri nuk mund të përdoret për zgjedhjet e parakohshme parlamentare të vitit 2020, për shkak të të dhënave jo të plota.²²


18 Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë Zyra e Institucioneve Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut. (2008). Zgjedhjet e parakohshme parlamentare 1 qershor 2008. Raporti Përfundimtar i Misionit të Vëzhgimit të Zgjedhjeve të OSBE/ODIHR Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë.

19 Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë Zyra e Institucioneve Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut. (2020). Zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 15 korrikut 2020. Raporti Përfundimtar i Misionit të Vëzhgimit të Zgjedhjeve të OSBE/ODIHR (fq.1). Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë.

20 Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë Zyra e Institucioneve Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut. (2016). Zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 11 dhjetorit 2016. Raporti Përfundimtar i Misionit të Vëzhgimit të Zgjedhjeve të OSBE/ODIHR Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë.

21 “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” N. 98/19

22 Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë Zyra e Institucioneve Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut. (2020). Zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 15 korrikut 2020. Raporti Përfundimtar i Misionit të Vëzhgimit të Zgjedhjeve të OSBE/ODIHR (pp.1). Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë.



4. SFIDAT DHE ÇËSHTJET KRYESORE TË IDENTIFIKUARA NË MAQEDONINË E VERIUT

Deri më sot, pavarësisht reformave të vazhdueshme zgjedhore, mbeten disa sfida për sistemin zgjedhor. Ky kapitull ofron një pasqyrë të rekomandimeve kryesore nga raportet e Misionit të Posaçëm të Vlerësimit të Zgjedhjeve të OSBE-ODIHR-së, të lëshuara pas secilës nga pesë zgjedhjet e fundit parlamentare në vend, duke iu referuar temave të diskutimit në këtë ngjarje të Sondazhit deliberativ.

Diskutimet për reformat e mëtejshme zgjedhore midis partive politike vijnë edhe sot, me përpjekjet për të zbatuar rekomandimet e paadresuara të OSBE-ODIHR dhe Komisionit të Venecias. Ndoshta më e rëndësishme, diskutimet mbi reformat e mëtejshme në modelin zgjedhor përfshijnë transformimin e vendit në një njësi të vetme zgjedhore në vend të gjashtë njësive zgjedhore aktuale dhe futjen e listave të hapura në vend të sistemit aktual të listave të mbyllura. Në vazhdim të materialeve, do të diskutojmë mbi reformat e mundshme zgjedhore, duke parashtruar argumente kundër dhe në favor të opsioneve të paraqitura.

4.1. NUMRI I NJËSIVE ZGJEDHORE

GJENDJA AKTUALE

Me ndryshimet ligjore të vitit 2002 u vendosën gjashtë njësi zgjedhore në vend. Siç u përmend më lart, secila nga këto njësi është me shumë mandate, që do të thotë se 20 deputetë zgjidhen nga çdo njësi zgjedhore. Nuk ka prag zgjedhor. Numri i votuesve për njësi zgjedhore mund të jetë maksimalisht +/- 5% nga numri mesatar i votuesve në njësinë zgjedhore.²³ Ndërsa njësitë nuk korrespondojnë me njësitë administrative ekzistuese, ato ndjekin kufijtë territorialë të komunave. Ndryshimet në njësitë zgjedhore u prezantuan në vitin 2020, ku ndryshimet në Kodin Zgjedhor parashikonin lëvizjen e dy komunave - Dibër dhe Mavrovë-Rostushë - nga njësia zgjedhore gjashtë në njësinë pesë. Megjithatë, ndryshimet nuk parashikonin ndryshime në njësitë zgjedhore tre dhe katër, pavarësisht devijimit në tejkalim të kufirit ligjor.²⁴

OPSIONET E MUNDSHME TË REFORMËS

Në vitin 2021, partitë e vogla qeverisëse kanë ndërmarrë një iniciativë të përbashkët në Kuvend për ndryshime në sistemin zgjedhor, duke kërkuar një njësi zgjedhore në vend të gjashtë të tanishme, pa prag zgjedhor. Megjithatë, diskutimet nëse do të ketë një prag zgjedhor (dhe cili do të jetë ky prag) nëse i gjithë vendi konsiderohet një njësi zgjedhore janë ende në vazhdim.

Duhet theksuar se ka disa opsione të mundshme reformash. Një prej tyre është ristrukturimi i kufijve gjeografikë aktualë të njësive zgjedhore, ose ndryshimi i numrit të njësive zgjedhore. Në këtë drejtim, disa nga propozimet nga partitë politike janë të reduktojnë numrin e njësive zgjedhore nga gjashtë në tre ose ta rrisin atë nga gjashtë në tetë, sipas rajoneve statistikore në vend. Sidoqoftë, duke pasur parasysh

23 "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" N. 40/06, 136/08, 148/08, 155/08, 163/08, 44/11, 51/11, 54/11, 142/12, 31/13, 34/13, 14/14, 30/14, 196/15, 35/16, 97/16, 99/16, 136/16, 142/16, 67/17, 125/17, 35/18, 99/18, 140/18, 208/18, 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" N. 98/19, 42/20, 74/21 dhe 215/21

24 Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë Zyra e Institucioneve Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut. (2020). Zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 15 korrikut 2020. Raporti Përfundimtar i Misionit të Vëzhgimit të Zgjedhjeve të OSBE/ODIHR Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë

kufizimet kohore dhe për të siguruar një diskutim më të fokusuar, për këtë ngjarje ne përqendrohemi vetëm në dy opsione të reformës që kanë dominuar debatin publik: (1) një status quo – territori i vendit mbetet i ndarë në gjashtë njësi zgjedhore dhe (2) i gjithë territori si një njësi zgjedhore.

Në praktikë, të kesh të gjithë territorin e vendit si një njësi zgjedhore do të thotë që të 120 deputetët të zgjidhen nga e njëjta njësi zgjedhore. Votat e hedhura në të gjithë vendin do të mblidhen dhe mandatet për secilën parti politike do të llogariten duke përdorur formulën d'Hondt.

Kjo mund të shihet si një reformë e madhe, dhe ndërsa nuk ka opsion të drejtë apo të gabuar, mendimet e ekspertëve janë të ndara se cili model do të ishte më i përshtatshëm për vendin. Ndërsa disa argumentojnë se modeli proporcional me gjashtë njësi zgjedhore është më i mirë, të tjerë argumentojnë se modeli proporcional me një njësi zgjedhore do të ishte më përfaqësues për vendin në tërësi. Pavarësisht argumenteve kontradiktore, qëllimi kryesor në vendosjen e modelit duhet të jetë sigurimi që të gjithë qytetarët të ndihen të përfaqësuar në mënyrë të përshtatshme në Parlament, sipas votave të tyre. Kjo do të thotë se secila parti duhet të ketë një numër mandatesh në parlament që korrespondon me mbështetjen që ka marrë në zgjedhje.

Argumentet pro dhe argumentet kundër dy opsioneve janë paraqitur në tabelën në vijim.

OPSIONE	ARGUMENTE PRO	ARGUMENTE KUNDËR
NË MAQEDONINË E VERIUT KA GJASHTË NJËSI ZGJEDHORE	<ol style="list-style-type: none"> 1. Praktika ka treguar se njësitë e shumëfishta zgjedhore kontribuojnë në bërjen e koalicioneve më të qëndrueshme qeverisëse, pasi partitë e vogla prirën të koalicionojnë me partitë më të mëdha para zgjedhjeve. 2. Njësitë zgjedhore mund të përmirësojnë llogaridhënien e përfaqësuesve ndaj votuesve të tyre. Në Maqedoninë e Veriut, bartësit e listës zakonisht janë politikanë që gëzojnë popullaritet në njësinë ku ata kandidojnë për zgjedhje, gjë që u jep votuesve një shans për t'u identifikuar me ta dhe për të formuar një lidhje më të ngushtë. 3. Njësitë e shumta zgjedhore mund të sigurojnë përfaqësim më të gjerë gjeografik dhe të komunitetit në Parlament, nëse kandidatët në listat në një njësi të caktuar janë banorë nga e njëjta njësi. 4. Listat e pavarura dhe kandidatët mund të kenë shanse më të mira për të konkurruar në zgjedhje në njësi të shumta zgjedhore në qoftë se elektorati i tyre potencial është i përqendruar gjeografikisht. Në këtë rast, do të ishte më e lehtë të mobilizoheshin votuesit dhe të mblidhej numri i nënshkrimeve të nevojshme në një territor më të vogël sesa të ishte në territorin e të gjithë njësisë. 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Partitë më të vogla, listat e qytetarëve dhe nismat e pavarura janë në disavantazh - të fitosh më shumë vota në tërësi (në total, nga të gjitha njësitë zgjedhore) sesa një parti/nismë tjetër nuk do të thotë domosdoshmërisht të fitosh një mandat deputeti, duke pasur parasysh se votat në një njësi të caktuar zgjedhore mund të jenë të pamjaftueshme për të fituar një mandat deputeti. Përveç kësaj, kjo mund t'i vërë pakicat e shpërndara gjeografikisht në rrezik të mos përfaqësohen. 2. Sipas modelit aktual në Maqedoninë e Veriut, numri i deputetëve të zgjedhur në çdo njësi zgjedhore nuk është proporcional me numrin e banorëve në njësitë zgjedhore. Me fjalë të tjera, si njësi zgjedhore me numrin më të ulët të votuesve dhe ajo me numrin më të lartë të votave zgjedhin të njëjtin numër të deputetëve (20). 3. Sistemet me më shumë se një njësi zgjedhore, sjellin rrezikun e përcaktimit të qëllimshëm të kufijve të njësive zgjedhore (gerrymandering), për të siguruar avantazh ose disavantazh për një parti ose komunitet të veçantë.

<p>I GJITHË TERRITORI I MAQEDONISË SË VERIUT ËSHTË NJË NJËSI E VETME ZGJEDHORE</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Partitë më të vogla do të kenë shanse më të mëdha për t'u përfaqësuar në parlament në një njësi të vetme zgjedhore, duke ditur se nevojiten më pak vota për një parti që të fitojë një vend në parlament. Kjo mund të jetë veçanërisht e mirë për komunitetet më të vogla (etnike). Kjo do të thotë se partitë e vogla nuk do të kenë nevojë domosdoshmërisht të formojnë koalicione parazgjedhore me partitë më të mëdha, por përkundrazi të kandidojnë me programin e tyre në zgjedhje. 2. Një njësi zgjedhore mund të nxisë më shumë qytetarë për të votuar, duke ditur se numri i deputetëve do të ndahet proporcionalisht me numrin e votave të marra në total, në të gjithë vendin. Në afat të gjatë, kjo mund të përmirësojë kulturën e votimit në vend dhe rrjedhimisht pjesëmarrjen e përgjithshme në ditën e zgjedhjeve. 3. Një njësi zgjedhore mund të kontribuojë në rritjen e numrit të partive të përfaqësuara në Kuvend. Në rastin e Maqedonisë së Veriut, kjo mund të rezultojë me më pak polarizim të kulturës politike midis dy partive më të mëdha në vend. 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Në shoqëritë shumetnike, një njësi e vetme zgjedhore mund të rezultojë me ndarje jo proporcionale të mandateve të deputetëve në krahasim me popullsinë, në qoftë se kultura e votimit ndryshon ndjeshëm midis komuniteteve etnike ose në qoftë se pengesat ndaj votimit ndryshojnë midis komuniteteve. 2. Në sistemet zgjedhore me një njësi zgjedhore, vendet zakonisht vendosin një prag ligjor (një minimum % të votave të nevojshme për të marrë një mandat deputeti), për të siguruar stabilitetin në Parlament. Megjithatë, nuk është e lehtë të përcaktohet pragu pasi mund të konsiderohet diskriminues për disa nga partitë e vogla dhe shpesh rezulton me vota «të humbura» (vota që hidhen për një parti që nuk përfundon duke fituar mandate deputetësh). 3. Vjen me rrezikun e hyrjes së partive të vogla radikale në Kuvend, të cilat në rastin e vendit tonë mund të kontribuojnë në më shumë bllokime të punës së Kuvendit dhe të sjelljes së ligjeve thelbësore (për shembull përmes filibastering ose paraqitjes së një numri të madh amendamentesh). 4. Një njësi e vetme zgjedhore mund të sjellë rrezikun e mbi-centralizimit të politikës në vend, duke pasur parasysh se do të ishte më e dobishme (dhe ndoshta më e lehtë) të përpiqesh të fitosh më shumë vota në qytetet më të mëdha (për shembull në Shkup) dhe si rezultat qytetet dhe rajonet më të vogla mund të përfundojnë të nënpërfaqësuar në Parlament. 5. Një njësi e vetme zgjedhore mund të çojë në përfaqësim më të dobët territorial dhe lidhje më të dobët votues-përfaqësues.
---	---	--

4.2. LISTAT E KANDIDATËVE PËR DEPUTETË

GJENDJA AKTUALE

Listat e kandidatëve u futën në sistemin zgjedhor të Maqedonisë së Veriut në vitin 2002, kur sistemi zgjedhor kaloi nga mazhoritar në proporcional. Listat e kandidatëve kanë qenë gjithmonë të tipit të mbyllur. Kjo do të thotë se partitë politike që kandidojnë në zgjedhje përgatisin dhe paraqesin në Komisionin Shtetëror Zgjedhor një listë të kandidatëve për deputetë sipas një rendi të paracaktuar, për secilën njësi zgjedhore. Prandaj, qytetarët nuk mund të shprehin preferencën e tyre për kandidatë të caktuar, por në vend të kësaj të hedhin votën e tyre për të gjithë listën e ofruar nga partia që ata vendosin të mbështesin në zgjedhje. Megjithatë, vlen të theksohet se partitë politike nuk i formojnë listat e tyre “me rastësi”. Meqenëse qëllimi i tyre është të tërheqin sa më shumë votues të jetë e mundur, partitë politike zakonisht kryejnë sondazhe për të përcaktuar popullaritetin e kandidatëve të tyre në të gjithë njësinë zgjedhore, për të siguruar që listat që ata paraqesin të korrespondojnë (pak a shumë) me preferencat e qytetarëve për kandidatët.

Është e rëndësishme të përmendet se kuotat gjinore për përfaqësimin e grave në listat e kandidatëve u futën në legjislacionin zgjedhor në vitin 2006. Deri në vitin 2015, kjo kuotë qëndronte në 30% të numrit të përgjithshëm të kandidatëve në të gjitha listat, dhe më pas me ndryshimet në Kodin Zgjedhor u vendos një kuotë më e lartë, duke përcaktuar se duhet të ketë të paktën 40% gra në çdo listë, me të paktën një në çdo tre pozicione të rezervuara për gjininë më pak të përfaqësuar (gratë), dhe gjithashtu të paktën një në çdo dhjetë pozicione në listë duhet të jetë një grua.²⁵

OPSIONET E MUNDSHME TË NDRYSHIMEVE

Siç shpjegohet në Kapitullin 2, ekzistojnë lloje të ndryshme të sistemeve me lista të hapura nga të cilat një vend mund të zgjedhë. Ngjashëm me vendimin për numrin e njësive zgjedhore, as në këtë rast nuk ka një zgjedhje që përshtatet për çdo rast. Dy dallime të mëdha në kalimin nga listat e mbyllura në ato të hapura do të jenë padyshim ngritja e nivelit të demokracisë brenda partisë dhe fakti se votuesit do të kenë një ndikim jo thjesht mbi vendosjen se cila parti merr më shumë mandate në parlament, por mbi vendosjen se kush do ti merr ato mandate gjithashtu.²⁶ Megjithatë, ndikimi i votuesve mbi zgjedhjen e individëve mund të dëmtojë balancin gjinor, pasi listat e hapura nuk kanë kuota gjinore (krahasuar me dispozitën ligjore aktuale me një kuotë të detyrueshme për gjininë më pak të përfaqësuar).

Deri tani, diskursi publik mbi listat e hapura ka qenë shumë i kufizuar, me pak ose aspak informacion mbi llojet e preferuara të partive politike për listat e hapura. Një praktikë e përgjithshme kur futen listat e hapura konsiderohet se po ecën ngadalë, pra duke filluar me llojin më pak të komplikuar të listave të hapura - listat e hapura me një preferencë, ku votuesit votojnë së pari për partinë që ata favorizojnë dhe pastaj nga lista ata zgjedhin një kandidat që ata besojnë se duhet të marrë një mandat.

Argumentet në favor dhe argumentet kundër të dy opsioneve janë paraqitur në tabelën në vijim. Duhet të theksohet se argumentet në lidhje me listat e hapura nuk i referohen ndonjë prej nënlojeve të sistemeve të listave të hapura (ose niveleve të ndryshme të "hapjes"), por përkundrazi janë karakteristika që zbatohen për listat e hapura në përgjithësi. Megjithatë, është gjithashtu e rëndësishme të kujtojmë se lloji më i zakonshëm i listave të hapura janë ato ku votuesit mund të japin vetëm nga një deri në tre vota preferenciale për kandidatët, pra votuesit nuk mund të votojnë për aq kandidatë sa ka mandate deputetësh për të mbushur në njësinë zgjedhore. Megjithatë, pavarësisht nga dallimet në zbatimin midis sistemeve të ndryshme të listave të hapura dhe detajet e tyre teknike, pikat e forta dhe të dobëta të përgjithshme janë të njëjta.²⁷

25 "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" N. 40/06, 136/08, 148/08, 155/08, 163/08, 44/11, 51/11, 54/11, 142/12, 31/13, 34/13, 14/14, 30/14, 196/15, 35/16, 97/16, 99/16, 136/16, 142/16, 67/17, 125/17, 35/18, 99/18, 140/18, 208/18, 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" N. 98/19, 42/20, 74/21 dhe 215/21

26 Blumenau, Jack, Eggers, Andy, Hangartner, Dominik and Hix, Simon (2016) Open/closed list and party choice: experimental evidence from the UK. British Journal of Political Science.

27 International Foundation for Electoral Systems (2009) Proportional Representation Open List Electoral Systems in Europe. (Fondacioni Ndërkombëtar për Sistemet Zgjedhore (2009) Përfaqësimi proporcional i sistemeve zgjedhore me listë të hapur në Evropë.) Çështjet e zgjedhjeve, Punimi 1. (Election Issues, Paper 1.)

OPSIONE	ARGUMENTE NË FAVOR	ARGUMENTE KUNDËR
LISTAT PËR KANDIDATËT PËR DEPUTETËT JANË LISTA TË MBYLLURA	<ol style="list-style-type: none"> Listat e mbyllura janë më praktike – përvoja ka treguar se shumë votues kujdesen më shumë për partinë sesa për kandidatët. Votuesit nuk duhet të ndjekin fushatat zgjedhore për secilin kandidat, por përkundrazi të përqendrohen në programin e përgjithshëm të partisë. Pavarësisht nga fakti se listat e partive janë të paracaktuara, partitë prirën të zgjedhin kandidatët që tashmë gëzojnë popullaritet më të madh në secilën prej njësive zgjedhore ku kandidojnë, bazuar në sondazhet e mëparshme me qytetarët. Përfaqësimi i grupeve të pafavorizuara të tilla si gratë dhe pakicat është më i lehtë për t'u siguruar me listat e mbyllura të paracaktuara. 	<ol style="list-style-type: none"> Votuesit nuk mund të shprehin preferencën e tyre për një kandidat të caktuar dhe as nuk mund të ndikojnë në përzgjedhjen e deputetëve, kështu që vendet e deputetëve shpërndahen në bazë të renditjes së kandidatëve të partisë, pra sa më lartë të jetë kandidati në listë, aq më shumë gjasa ka që ai të zgjidhet deputet. Anëtarët e parlamentit prirën të jenë më besnikë ndaj partisë sesa ndaj elektoratit të tyre, pasi është partia ajo që përcakton vendin e tyre në listë. Ndonjëherë mund të ndodhë që edhe pse një kandidat gëzon shumë popullaritet në mesin e elektoratit, ai/ajo ende nuk është vendosur mjaft lartë në listë (duke rritur shanset e tyre për t'u zgjedhur deputet), për shkak të dinamikës së brendshme të partisë.
LISTAT PËR KANDIDATËT PËR ANËTARË TË PARLAMENTIT JANË LISTA TË HAPURA	<ol style="list-style-type: none"> Listat e hapura janë më demokratike se listat e mbyllura meqenëse u mundësojnë votuesve të zgjedhin drejtpërdrejt individët që bëhen deputetë - zgjidhen kandidatët me më shumë vota individuale. Ai u jep votuesve ndjesinë se ata janë më shumë në kontroll se kush i përfaqëson ata. Kandidatët për deputetë do të fitojnë më shumë pavarësi nga udhëheqësi i partisë së tyre, i cili në afat të gjatë mund të kontribuojë në dobësimin e partiokracisë, reduktimin e centralizimit të partisë dhe reduktimin e pushtetit të udhëheqësve të partisë, duke përmirësuar në thelb demokracinë e brendshme të partisë. Listat e hapura mund t'i bëjnë deputetët e zgjedhur të ndihen më të përgjegjshëm ndaj elektoratit të tyre, duke kontribuar në një degë legjislative më të përgjegjshme dhe një cilësi më të mirë qeverisjeje. Në varësi të faktorëve të tjerë (si modeli zgjedhor dhe pragu zgjedhor), listat e hapura mund t'u ofrojnë partive të vogla (jo atyre në koalicion parazgjedhor) dhe listave dhe kandidatëve të pavarur një shans më të mirë për një konkurrencë kuptimplotë. Partitë dhe listat e pavarura do të shkojnë drejt prezantimit të më tepër kandidatëve të tyre gjatë fushatës zgjedhore, në vend që të përqendrohen vetëm në kandidatin e parë në listë. 	<ol style="list-style-type: none"> Fletëvotimet do të jenë shumë të gjata që mund të rrisë ndjeshëm kohën e votimit (linja më të gjata të pritjes, etj.). Mund të dekurajojë gjithashtu qytetarët të dalin të votojnë, pasi procesi i votimit mund të duket tepër i komplikuar. Përveç kësaj, mund të rezultojë me shumë fletëvotime të pavlefshme, për shkak të gabimeve në votim nga qytetarët që nuk janë të edukuar sa duhet mbi rregullat për votim me lista të hapura. Edhe në qoftë se listat janë plotësisht të hapura, është e diskutueshme se sa ndryshim do të ketë për votuesit. Praktika ka treguar se në shumë lista gjysmë të hapura dhe sisteme të listave të hapura, votuesit prirën të zgjedhin ose kandidatët që gëzojnë popullaritet më të madh ose kandidatët që janë tashmë në krye/pjesën e sipërme të listës. Gjithashtu mund të ndodhë që kandidatët të përfundojnë duke votuar vetëm për partinë dhe aspak për kandidatët. Futja e listave të hapura do të kërkojë një fushatë të rëndësishme të edukimit të votuesve, jo vetëm se si të votojnë, por gjithashtu për të kuptuar se si numërohen votat dhe si caktohen mandatet e deputetëve. Për shembull, në varësi të pragut (nëse ka) të votave të nevojshme për caktimin e një mandat deputeti, listat e hapura mund të japin rezultate kundër-intuitive (Pse një kandidati me më pak vota se një kundërshtari i jepet një mandat?). Listat e hapura mund të shpien në konflikt brenda-partiak duke ditur se kandidatët nga e njëjta parti po konkurrojnë me njëri-tjetrin për vota. Në mënyrë që të tërheqin më shumë votues, partitë mund të përdorin individë të shquar si kandidatë, të cilët mund të heqin dorë nga mandati i tyre pasi të zgjidhen.

4.3. VOTIMI JASHTË VENDIT

GJENDJA AKTUALE

Që nga viti 2015, votimi jashtë vendit kryhet në një njësi zgjedhore (Evropa, Afrika, Amerika e Veriut dhe Jugut, Australia dhe Azia), ku deri në tre deputetë zgjidhen sipas sistemit proporcional. Sipas Kodit Zgjedhor, zgjedhja e këtyre deputetëve është si më poshtë:

- Deputeti i parë zgjidhet nëse lista e kandidatëve ka marrë të paktën aq vota sa ka marrë deputeti i zgjedhur me numrin më të vogël të votave në njësitë zgjedhore në vend, gjatë zgjedhjeve të fundit parlamentare.
- Deputeti i dytë zgjidhet nëse lista e kandidatëve ka marrë të paktën dyfishin e votave se sa deputeti i zgjedhur me numrin më të vogël të votave në njësitë zgjedhore në vend, gjatë zgjedhjeve të fundit Parlamentare.
- Deputeti i tretë zgjidhet nëse lista e kandidatëve ka marrë të paktën tre herë më shumë vota se sa deputeti i zgjedhur me numrin më të vogël të votave në njësitë zgjedhore në vend, gjatë zgjedhjeve të fundit parlamentare.

Sipas Kodit Zgjedhor, qytetarët që janë 18 vjeç ose më lart, kanë banim të fundit të regjistruar në Maqedoninë e Veriut, kanë një pasaportë maqedonase dhe në ditën e zgjedhjeve banojnë përkohësisht jashtë vendit për një periudhë më të gjatë se tre muaj ose punojnë përkohësisht jashtë vendit për më shumë se një vit, kanë të drejtë të votojnë.

Krahasuar me regjistrimin pasiv të votuesve brenda vendit, votuesit jashtë vendit duhet të regjistrohen për votim përpara zgjedhjeve. Një minimum prej 10 votuesish duhet të regjistrohen me qëllim që votimi të bëhet në një përfaqësi diplomatike-konsullore. Regjistrimi kërkohet përpara çdo zgjedhjeje dhe votimi lejohet vetëm personalisht, që ndonëse është metoda më e përdorur globalisht, mbetet e kufizuar bazuar në numrin dhe vendndodhjen e zyrave diplomatike-konsullore ku mund të zhvillohet votimi jashtë vendit. Kodi Zgjedhor përcakton se votimi i jashtëm bëhet një ditë përpara zgjedhjeve brenda vendit. Bazuar në dendësinë relativisht të vogël të rrjetit të përfaqësimit diplomatik të vendit, koha e shkurtër për votim dhe nevoja e përsëritur për regjistrim gjithashtu kontribuojnë në pjesëmarrje më të ulët. Gjatë zgjedhjeve të vitit 2020, nuk ka pasur votim të diasporës pasi janë regjistruar më pak votues se sa kërkohet në total – pragu i kërkuar prej 6534 votuesish të regjistruar,²⁸ i përcaktuar në bazë të zgjedhjeve parlamentare të vitit 2016, nuk është përmbushur.

Njësoj si për votimin brenda vendit, edhe për votimin jashtë vendit janë ngritur këshillat zgjedhorë. Këto këshilla zgjedhorë në zyrën diplomatike-konsullore (DCO) përbëhen nga një kryetar dhe katër anëtarë, secili me zëvendësin e tij. Kryetari dhe zëvendës-kryetari janë diplomatë, ndërsa opozita më e madhe dhe partia më e madhe qeverisëse propozojnë secili nga dy anëtarë dhe zëvendësit e tyre.

OPSIONET E MUNDSHME TË REFORMËS

E drejta e votës është një e drejtë e garantuar me kushtetutë për çdo qytetar të Maqedonisë së Veriut, kështu që debati nëse jorezidentët duhet të votojnë jashtë vendit ose jo është mjaft i ndjeshëm, duke pasur parasysh se marrëdhënia e tyre me shtetin ndryshon kur ata largohen nga territori i vendit të tyre, veçanërisht për një periudhë të zgjatur kohore.²⁹ Megjithatë, marrëdhëniet ekonomike midis jorezidentëve

28 Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë Zyra e Institucioneve Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut. (2020). Zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 15 korrikut 2020. Raporti Përfundimtar i Misionit të Vëzhgimit të Zgjedhjeve të OSBE/ODIHR Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë.

29 Collyer, Michael and Vathi, Zana (2007) Patterns of Extra-territorial Voting (working paper). Development Research Centre on Migration, Globalization and Poverty.

dhe vendit të tyre të lindjes mbeten të forta shumë shpesh, prandaj ky element duhet llogaritur. Përveç kësaj, si shtetas maqedonas, politika e jashtme e vendit i ndikon ata dhe ata varen nga mbrojtja e vendit. Sidoqoftë, vendet që llogariten për kostot administrative dhe financiare për organizimin e votimit jashtë vendit duhet gjithashtu të merren në konsideratë.

Në mënyrë intuitive, ka vetëm dy përgjigje për pyetjen nëse jorezidentët duhet të kenë të drejtën të votojnë jashtë vendit – po ose jo. Në të njëjtën kohë, ka modalitete të ndryshme që janë në lojë, nëse vendi zgjedh për votim jashtë vendit, domethënë numri i raundeve, numri i mandateve të deputetëve, formula për shpërndarjen e votave, mënyra e votimit, etj.

Duke pasur parasysh përvojën e mëparshme në vend me votimin jashtë vendit, për qëllime të kësaj ngjarjeje të sondazhit deliberativ ne paraqesim tre opsione: (1) një status quo, domethënë jorezidentët mund të votojnë në një njësi zgjedhore dhe të zgjedhin deri në tre deputetë; (2) jorezidentët mund të votojnë në një njësi zgjedhore dhe të zgjedhin një deputet; dhe (3) nuk ka votim jashtë vendit fare.

Argumentet në favor dhe argumentet kundër tre opsioneve janë paraqitur në tabelën e mëposhtme. Duhet të theksohet se argumentet në favor dhe kundër që i referohen opsionit të parë janë gjithashtu të vlefshme për opsionin e dytë, pasi të dy opsionet supozojnë se votimi jashtë vendit do të bëhet. Argumentet e paraqitura për opsionin e dytë përqendrohen në argumentet pro dhe kundër zgjedhjes së vetëm një, në vend të tre deputetëve.

OPSIONE	ARGUMENTE PRO	ARGUMENTE KUNDËR
JO-REZIDENTËT VOTOJNË DHE ZGJEDHIN DERI NË 3 DEPUTETË	<ol style="list-style-type: none"> 1. Çdo person që ka shtetësi maqedonase mund të ushtrojë të drejtën e tij kushtetuese të votës, pavarësisht nga fakti nëse jeton brenda apo jashtë vendit. 2. Jo-rezidentët kanë shansin të përfaqësohen në Parlament dhe të ndikojnë në çështje të rëndësishme për ta, të tilla si shërbimet e ofruara nga vendi i tyre (për shembull lëshimi i pasaportave dhe dokumenteve të tjera). 3. Jorezidentët dërgojnë një sasi të konsiderueshme mjeteve financiare në atdhe, gjë që është arsyeja pse vendi duhet të forcojë lidhjet e tij me ta. Për më tepër, disa jorezidentë ende kanë biznesin e tyre në vend ose një lloj investimesh financiare, kështu që ata kanë një interes të vërtetë në legjislacionin kombëtar të pagimit të taksave dhe hartimin e politikave në vend, pavarësisht se nuk jetojnë në vend, dhe duhet të jenë në gjendje të ushtrojnë të drejtën e tyre të votës. 4. Jorezidentët afatshkurtër do të jenë ende në gjendje të ushtrojnë të drejtën e tyre për të ndikuar në politikë bërjen e ardhshme në vendin e tyre, që do të ndikojë mbi ta pasi të kthehen në vendin ku banojnë. 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Numri i votuesve të regjistruar dhe votuesve aktualë nga diaspora po zvogëlohet nga një zgjedhje në tjetrën, ndërsa shpenzimet për organizimin e zgjedhjeve në diasporë mbeten të larta. 2. Jo-rezidentët shpesh nuk ndajnë të njëjtat çështje me banorët dhe nuk paguajnë taksa në vendin e tyre 3. Është e vështirë të organizohen pasi nuk ka të dhëna të sakta për jorezidentët. Edhe pse jorezidentët duhet të regjistrohen për të votuar përpara zgjedhjeve, me qëllim që të bëhet votimi, kërkohet së paku 10 shtetas të regjistrohen për të votuar në një zyrë diplomatiko-konsullore. Në rast se regjistrohen më pak se 10 persona, ata nuk mund të ushtrojnë të drejtën e votës. 4. Lënë hapësirë për grindje partiake dhe 'blerje të votave' me qëllim të fitimit të votave të diasporës.
JO-REZIDENTËT VOTOJNË DHE ZGJEDHIN NJË DEPUTET	<ol style="list-style-type: none"> 1. Qytetarët jorezidentë ushtrojnë të drejtën e tyre të votës. Ata do të përfaqësohen në parlament nga një deputet, megjithatë vota e tyre nuk do të ndikojë ndjeshëm në përfundimin e zgjedhjeve sipas votave të votuesve rezidentë. 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Do të ishte e vështirë për një deputet të përfaqësohej të gjithë diasporën, duke pasur parasysh se interesat e jo-rezidentëve mund të ndryshojnë në bazë të vendndodhjes së tyre gjeografike. Meqenëse deputetët duhet të mbajnë kontakt të rregullt me elektoratin e tyre, koha dhe burimet mund të jenë një pengesë e madhe në këtë skenar.

**JOEZIDENTËT
NUK VOTOJNË**

1. Kostot nga buxheti i dedikuar për organizimin e zgjedhjeve janë reduktuar ndjeshëm.
2. Jorezidentët afatgjatë janë natyrisht më pak të angazhuar dhe të informuar rreth politikës në vendin e tyre dhe mund t'u mungojë informacioni i nevojshëm për të marrë një vendim të shëndoshë në ditën e zgjedhjeve dhe përgjegjësia për të ushtruar zgjedhjen me mençuri, pasi ata nuk do të ndikoheshin drejtpërdrejt. Prandaj vendimmarrja duhet t'u lihet banorëve, pasi ata kanë më shumë gjasa të mbajnë pasojat politike.
3. Mandatet e fituara nga partitë politike nga votimet jashtë vendit mund të jenë vendimtare se cila parti do të formojë Qeverinë, në qoftë se rezultatet brenda vendit japin një numër shumë të ngjashëm mandatesh midis dy partive mbizotëruese. Në këto raste, është e diskutueshme nëse qytetarët jorezidentë duhet të vendosin për rregulloren që zbatohet për qytetarët rezidentë.
4. Jo të gjitha partitë politike kanë burime të mjaftueshme për të bërë fushatë dhe për të mobilizuar votuesit jashtë vendit, kështu që partitë më të mëdha (me më shumë burime) kanë një avantazh të rëndësishëm ndaj partive më të vogla.

1. Përvojat krahasuese nga rajoni kanë treguar se jorezidentët kryesisht mbështesin partitë konservatore të krahut të djathtë, të cilat shpesh i përdorin këto vota për të krijuar tension shtesë midis partive politike.
2. Heqja e votimit në diasporë mund të shkaktojë potencialisht ndarje të reja midis shtetasve që jetojnë brenda dhe jashtë vendit (përgjatë vijave etnike, fetare, partiake)
3. E drejta e votës e garantuar me kushtetutë nuk mund të ushtrohet nga çdo shtetas maqedonas.
4. Jorezidentët formojnë komunitete politike dhe ekonomike dhe i përdorin ato për lobim dhe avokim për vendin e tyre në institucionet e vendeve ku banojnë. Marrja e të drejtës të votimit mund të ulë përpjekjet e tyre të lobimit dhe avokimit.
5. Përveç jorezidentëve afatgjatë, jorezidentëve afatshkurtër do t'u hiqet gjithashtu e drejta për të ndikuar në të ardhmen e politikë bërjes në vendin e tyre.

4.4. REGJISTRIMI I VOTUESVE

GJENDJA AKTUALE

Sipas legjislacionit aktual, Lista zgjedhore mirëmbahet dhe përditësohet nga Komisioni Shtetëror Zgjedhor dhe bazohet në të dhënat nga Regjistri i Qytetarëve (Regjistri amë) dhe, që nga viti 2019, në Regjistrin Qendror të Popullsisë. Kjo do të thotë se regjistrimi i votuesve brenda vendit është pasiv, domethënë të gjithë votuesit me të drejtë vote janë regjistruar në listë duke kontrolluar në mënyrë të kryqëzuar grupet përkatëse të të dhënave. Lista zgjedhore përmban të gjithë shtetasit e vendit që kanë mbushur 18 vjet në ditën e zgjedhjeve dhe që janë banorë të vendit. Informacioni për ata shtetas që janë me qëndrim të përkohshëm në një vend të huaj për qëllime pune ose studimi dhe që kanë një qëndrim të vlefshëm në territorin e Maqedonisë së Veriut, të cilët nuk janë regjistruar për të votuar në një Zyrë Diplomatie-Konsullore, gjendet në një Listë të veçantë të Votuesve. Qytetarët që janë të punësuar përkohësisht ose banojnë jashtë vendit gjatë zgjedhjeve dhe janë regjistruar për votim jashtë vendit në ZDK-të ose zyrat konsullore nuk do të përfshihen në Listën zgjedhore që përdoret për votim në Maqedoninë e Veriut.³⁰

Çdo shtetas me të drejtë vote mund të kontrollojë saktësinë e të dhënave të tij në Listën zgjedhore, ose online ose në zyrat e Komisionit Shtetëror Zgjedhor, para Ditës së Zgjedhjeve, pasi Lista zgjedhore përditësohet para çdo cikli zgjedhor. Nëse votuesi nuk është në Listë dhe ka një dokument identifikimi/pasaportë të vlefshme, ai mund të paraqesë një kërkesë për t'u shtuar në Listë, online ose në zyrat e Komisionit Shtetëror Zgjedhor. Partitë politike gjithashtu mund të vënë në dukje parregullsi në të dhënat.


Në Ditën e Zgjedhjeve, votuesit duhet të paraqesin një dokument identifikimi të vlefshëm në Ditën e Zgjedhjeve në mënyrë që të jenë në gjendje të votojnë. Identifikimi i gjurmëve të gishtave të votuesve u prezantua për zgjedhjet lokale në vitin 2021, ku secili votues kishte identitetin e tij të kontrolluar përmes gjurmës së gishtit dhe kontrollit të dokumentit të identifikimit.

OPSIONET E MUNDSHME TË REFORMËS

Një alternativë ndaj regjistrimit pasiv të votuesve është regjistrimi aktiv i votuesve. Në praktikë, kjo do të thotë se me qëllim që qytetarët e mundshëm të jenë në gjendje të votojnë, ata duhet të regjistrohen vetë përpara zgjedhjeve, brenda afateve të caktuara dhe duke ndjekur procedura të posaçme, të paracaktuara nga autoritetet përkatëse. Ekzistojnë mënyra të ndryshme për të organizuar regjistrimin aktiv të votuesve, por duke pasur parasysh se vendi tashmë përdor një sistem specifik për regjistrimin aktiv të votuesve për votim jashtë vendit, e njëjta gjë mund të zbatohet për zgjedhjet brenda vendit, ose të modifikohet sipas mundësive dhe burimeve në dispozicion (teknike, financiare, etj.) Argumentet në favor dhe argumentet kundër të dy opsioneve paraqiten në tabelën e mëposhtme.

³⁰ "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" N. 40/06, 136/08, 148/08, 155/08, 163/08, 44/11, 51/11, 54/11, 142/12, 31/13, 34/13, 14/14, 30/14, 196/15, 35/16, 97/16, 99/16, 136/16, 142/16, 67/17, 125/17, 35/18, 99/18, 140/18, 208/18, 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" N. 98/19, 42/20, 74/21 dhe 215/21

OPSIONE	ARGUMENTE PRO	ARGUMENTE KUNDËR
<p>VOTUESIT DUHET TË REGJISTROHEN VETË NË MËNYRË QË TË JENË NË GJENDJE TË VOTOJNË</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Regjistrimi aktiv i votuesve siguron që të gjithë ata që kanë të drejtë të votojnë mund ta bëjnë këtë, duke parandaluar votimin e njerëzve që nuk kanë të drejtë vote (për shembull njerëzit e vdekur ose të emigruar përgjithmonë) dhe votimin e shumëfishhtë nga i njëjti individ. 2. Rritja e teknologjisë së informacionit e bën më të lehtë zhvillimin e një sistemi për regjistrimin online të votuesve, i cili është i lehtë për t'u aksesuar dhe kërkon më pak kohë. Një vlerë e shtuar për Maqedoninë e Veriut është Regjistri Kombëtar ekzistues i Popullsisë që mund të shërbejë si bazë për kontrollin e kryqëzuar të të dhënave. 3. Ai kufizon mundësitë për mashtrim zgjedhor dhe blerje të votave, që është konstatuar gjatë disa zgjedhjeve në të kaluarën, në Maqedoninë e Veriut. Prandaj, regjistrimi aktiv i votuesve mund të kontribuojë në zgjedhje më të besueshme në të ardhmen dhe të rrisë besimin në procesin zgjedhor dhe rezultatin e tij. 4. Nëse regjistrimi aktiv është i detyrueshëm për një person që të jetë në gjendje të ushtrojë të drejtën e tij të votës, ai mund të sigurojë të dhëna të rëndësishme dhe relevante për klimën e votimit në vend, të cilat më pas mund të përdoren për fushata edukative të bazuara në prova 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Regjistrimi aktiv i votuesve kërkon iniciativë qytetare, prandaj ky sistem mund të lërë jashtë shumë që përndryshe do të kishin të drejtë të votonin, veçanërisht nëse ka nivele të larta të apatisë së votuesve ose nivele të ulëta të edukimit të votuesve. 2. Sistemi i hartuar në mënyrë të papërshtatshme për regjistrimin aktiv të votuesve mund të vërë në disavantazh grupe të caktuara njerëzish. Për shembull, nëse qasja në zyrat e regjistrimit është e vështirë, mund kërkojë shumë kohë për njerëzit me orë të gjata pune. Nëse orët e punës janë të kufizuara, gratë me fëmijë të vegjël ose ato pa qasje të lehtë në transport (të moshuar ose me aftësi të kufizuara) mund të dekurajohen nga regjistrimi. Nëse sistemi mundëson vetëm regjistrimin elektronik, është një rrezik për qytetarët që ose nuk janë shumë të aftë në fushën teknologjike, ose nuk kanë qasje në pajisjet IT. 3. Kompleksiteti i regjistrimit aktiv të votuesve nënkupton përpilimin dhe mbajtjen e listave të sakta të praktikisht gjithë qytetarëve të rritur në një vend dhe vendbanimin e tyre, prandaj do të kërkojë kapacitete të forta administrative (ndoshta duke përfshirë një shumëllojshmëri të autoriteteve lokale dhe kombëtare) dhe burime financiare (shpesh është pjesa më e kushtueshme e zgjedhjeve). 4. Ajo do të kërkojë mjaft kohë dhe burime financiare për komunikimin dhe fushatat arsimore për votuesit anëmbanë vendit. 5. Partitë politike mund të ushtrojnë presion mbi anëtarët e tyre për t'u regjistruar për të votuar ose mund të abuzojnë me procedurën dhe të regjistrojnë votuesit në emër të tyre.
<p>VOTUESIT NUK DUHET TË REGJISTROHEN VETË PËR TË VOTUAR, LISTA ZGJEDHORE PËRGATITET NGA KOMISIONI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE (STATUS QUO)</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Sistemet e iniciuara nga shteti për regjistrimin e votuesve kanë më shumë gjasa të sigurojnë që të gjithë votuesit e mundshëm të regjistrohen (nëse administrohen mirë), por kjo nuk garanton pjesëmarrje të lartë. 2. Asnjë burim administrativ dhe financiar shtesë nuk do të shpenzohet për të edukuar shtetasit mbi ndryshimet në mjetet e regjistrimit për votim. 3. Edhe në qoftë se njerëzit duan të votojnë por nuk ja dalin të regjistrohen vetë për arsye të ndryshme, ata do të jenë ende në gjendje të ushtrojnë të drejtën e tyre të votës. 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Regjistrat e të dhënave nga institucionet e ndryshme shpesh nuk janë të përputhshëm dhe për këtë arsye kryqëzimi i të dhënave është problematik. Në rast të një skenari status quo, nuk ka garanci që Lista zgjedhore do të 'pastrohet' për të siguruar që vetëm shtetasit që kanë të drejtë të votojnë janë në listë dhe që të dhënat janë të sakta. 2. Zgjedhjet e shpeshta (shpesh të parakohshme) në Maqedoninë e Veriut kërkojnë të dhëna të përditësuara dhe të sakta për qytetarët, në mënyrë që të sigurohet një listë e përditësuar e votuesve, bazuar në të dhënat nga institucione të ndryshme. Praktika ka treguar se edhe pse detyrimet ligjore për sigurimin e të dhënave më të fundit, të sakta, partitë qeverisëse mund ta (keq)përdorin këtë për interesat e tyre, duke kufizuar kështu garancitë për saktësinë e Listës zgjedhore.



 EPI.Skopje

 epi_mk

 www.epi.org.mk